



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures



Arsimimi

KULTURA E NJERIUT

Ë-buletin




Dhjetor, 2014

Fjala e redaksisë

Të nderuar lexues të gazetës sonë elektronike, duke iu përshëndetur dhe falënderuar për bashkëpunimin tuaj gjatë vitit që lëmë pas, urojmë që viti 2015 të jetë vit i suksesshëm për ju dhe familjet e juaja.

Në këtë numër të ri të gazetës elektronike, ju mund të lexoni aktivitetet që ka realizuar SBASHK-ut gjatë muajit dhjetor. Shpresojmë dhe besojmë në angazhimin dhe bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Gëzuar Vitin e Ri 2015!



SBASHK-u në tetor ka shtuar anëtarësinë me 477, ndërsa në nëntor edhe me 564 anëtarë të rinj

Ndjehet mirë njeriu kur shkruan dhe publikon lajme të mira, sepse i gëzon të gjithë njerëzit e vullnetit të mirë. Një lajm të tillë po ua nisim edhe në këtë numër të ri të gazetës. SBASHK-u po bëhet çdo muaj e më i fuqishëm falë përkushtimit në qendër dhe të kryetarëve e veprimtarëve sindikalë nëpër komunat e Kosovës. Në muajin tetor, në SBASHK janë regjistruar 477 anëtarë të rinj. Në nëntor vazhdoi ky trend pozitiv dhe në fillim të dhjetorit SBASHK-u ka edhe 564 anëtarë të rinj. Pra, vetëm për 2 muaj, kolegë të nderuar sindikalistë, SBASHK-ut iu shtuan radhët për 1041 anëtarë.

Ne të gjithë do të vazhdojmë me përkushtim që të kemi arritje të reja, që radhët të shtohen dhe kështu zëri i SBASHK-ut të jetë edhe më i fuqishëm në mbrojtjen e të drejtave dhe në realizimin e kërkesave legjitime të anëtarësisë. Së bashku sfidat i kalojmë më lehtë edhe sukseset e përbashkëta i kemi më të mëdha. Pra, të vazhdojmë me angazhimet bashkë për SBASHK.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



Përfundoi me sukses Konferenca Ndërkombëtare e organizuar nga SBASHK dhe KEC



Më 10 dhjetor ka përfunduar më sukses Konferenca ndërkombëtare “Sindikatat e Arsimit sot- Arritjet dhe Sfidat”. Kjo ngjarje është konsideruar si rrumbullakësim i aktiviteteve të shumta nga projekti i përbashkët i SBASHK-ut dhe KEC-it “Fuqizimi i rolit të SBASHK-ut në hartimin e politikave arsimore”, e që mbështet nga BE përmes zyrës së saj në Prishtinë.

Kontributin e tyre në këtë Konferencë e kanë dhënë sindikalistë të njohur nga AOB i Holandës dhe sindikatat e Sllovenisë,

Shqipërisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe veprimtarë e udhëheqës të SBASHK-ut nga qendra dhe gjithë komunat e Kosovës.

Pasi është konstatuar se SBASHK-u po shënon arritje edhe falë projektit në fjalë, Konferenca ka pasur një rrjedhë efektive duke u punuar në sesione plenare.

Ligjëruesit në bashkëbisedë me 120 pjesëmarrësit e Konferencës kanë këmbyer përvojat e shteteve pjesëmarrëse dhe i kanë krahasuar me arritjet e SBASHK-ut.

Përfaqësuesi i AOB-it, z.Gerhardus Stemerding ka lavdëruar SBASHK-un duke i përkujtuar edhe sfidat që e presin. Zonja Marjana Kolar ka përcjellur përkrahjen e sindikalistëve të Sllovenisë dhe ka prezantuar para pjesëmarrësve shërbimet që i ofron SVIZ për anëtarët e saj.

Ajo ka thënë se SBASHK-u po shënon arritje dhe se do të mbetet mik i përkushtuar i SVIZ-it.

Përfaqësuesit nga Maqedonia z.Jakim Nedelkov, znj. Vesna Nedelkovska, ata të Malit të Zi znj.Sandra Martiq dhe z.Slobodan Dragash, si dhe përfaqësuesit nga Shqipëria z.Nevruz Kaptelli, Fatmir Bezati dhe z.Isa Halili kanë deklaruar se do ta vazhdojnë bashkëpunimin me SBASHK-un. Të gjithë kanë shprehur respekt për përpjekjet që SBASHK po i bënë për forcimin e bashkëpunimit me sindikatat simotra në Ballkan, Evropë e kudo në botë. Profesorët z.Agim Hyseni e z.Dukagjin Pupovci kanë dhënë kontributin e tyre në shërbim të ecjeve përpara të sindikatës së arsimit.

Punimet e Konferencës i kanë përcjellë nga afër edhe përfaqësueset e zyrës së BE-së në Kosovë znj.Dragana Stolic dhe znj.Gaby Hagmuller. Znj.Hagmuller ka thënë se BE ia ka qëlluar me përkrahjen që i ka bërë këtij projekti sepse janë duke u parë çdo ditë e më shumë frytet e tij.

Ajo ka premtuar përkrahje edhe në të ardhmen për zhvillimin e dialogut social dhe forcimin e SBASHK-ut në të gjitha sferat.

Vlen të theksohet se edhe pjesëmarrësit e tjerë kanë marrë pjesë aktive në punimet e Konferencës dhe kanë bërë që



ajo të përmbyll punimet me konkluzione të qarta që do t'i shtohen planit të strategjisë së SBASHK-ut për vitet 2015-2019.

Në mbyllje të kësaj Konference është arritur një marrëveshje që sindikatat pjesëmarrëse të shtojnë vizitat te njëra tjetra në mënyrë që të krijojnë një frymë të besimit e mirëkuptimit në mes të mësimdhënësve të shteteve të Ballkanit dhe Evropës.

Projekti i KEC dhe SBASHK kështu po hyn në vitin e dytë për të sjellë risi dhe arritje të reja.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsimit e Kosovës

KEC



Letër publike kryeministrit të Kosovës, z. Isa Mustafa

13 dhjetor 2014 - Keq ia ke nisur udhëheqjen e shtetit o Kryeministër Mustafa. E the në një medie të huaj se nuk do të ketë rritje nga ajo që është premtuar. E the me të parën e pa e ndërë të nevojshme as të takoheshe në një takim përshëndetës e njohës me Sindikatat. Rritja është premtuar z. Kryeministër i tashëm dhe Atij që e kishte premtuar i besuan njerëzit, i besuan edhe shumica e mësimdhënësve sepse premtimet Ai i kishte mbajtur. Kjo deklaratë jotja është një goditje me të parën ndaj të punësuarve në sektorët publik dhe ata nuk besoj se do të heshtin.

I nderuari Kryeministër i tashëm premtimi për rritjen është thënë qindra herë dhe është detyrë e Qeverisë ta mbajë premtimin, por unë po të drejtohem edhe për diçka tjetër. Kështu si ia keni nisur me JO e (s'ka) do të krijoni atmosferë të keqe dhe lëvizje sociale. Si kryetar i SBASHK-ut dhe si zë i mijëra mësimdhënësve të Kosovës po të lus mos e përdor aq lehtë fjalën JO. JU kujtoj Juve dhe gjithë Qeverinë se të punësuarit kanë nënshkruar Marrëveshjen e përgjithshme Kolektive, kurse ne SBASHK-u kemi

nënshkruar edhe Kontratën Kolektive. Nuk e kemi bërë këtë me njerëz të thjeshtë e as ne ndëja private. Kontratën e kemi nënshkruar me MASHT-in dhe në shenjë mirëkuptimi e respekti e për hir të shtetit të Kosovës kemi lëshuar pe që 4 pikat kyçe të implementohen në janar të vitit 2015, ngase në vitin 2014 nuk ishin bërë planifikime buxhetore për këtë dhe na është kërkuar kohë që kjo të bëhet. Ne atëherë kemi lëshuar pe, por nuk do të veprojmë kështu edhe në janar.

I nderuari Kryeministër i tashëm, unë si kryetar dhe gjithë anëtarët e SBASHK-ut po të kujtojnë se Kontrata Kolektive duhet vënë në jetë e tëra. JU keni pranuar të jeni në krye të qeverisjes së shtetit dhe duhet t'i keni pasur parasysh edhe gjithë ato që Ju presin. Në janar do të ketë implementim të plotë të Kontratës sonë ose, pa fajin tonë, do të ketë protesta e veprime tjera sindikale, që lejohen edhe me Ligjin mbi grevat edhe me akte ndërkombëtare. Mos harro këto këshilla me qëllimin më të mirë i nderuari Kryeministër i tashëm i Kosovës.

Rrahman Jasharaj,
Kryetar i SBASHK-ut

Letër informuese institucioneve shtetërore

24 dhjetor 2014 - Kryetari i SBASHK-ut z. Rrahman Jasharaj përmes një letre publike drejtuar Presidentes, Kryeministrit, Kryetarit të Kuvendit, Ministrit të Arsimit dhe Ministrit të Financave u ka bërë të ditur se nëse deri më 9 janar nuk reflektoni me ngritjen e pagave për 25%, atëherë më 10 janar hyjmë në grevë të përgjithshme dhe nuk do të mbajmë mësim në shkollat fillore e të mesme të Kosovës.

- Presidentes së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga,
- Kryeministrit të Kosovës, z. Isa Mustafa,
- Kryeparlamentarit, z. Kadri Veseli,
- Ministrit në MASHT, z. Arsim Bajrami,
- Ministrit në MF, z. Avdullah Hoti

Të nderuar udhëheqës të lartë të shtetit të Kosovës Ju përshëndes në emër të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK).

Të nderuar udhëheqës të lartë të shtetit të Kosovës, duke u gjendur në një situatë të re dhe aspak të këndshme, pasi që u deklarua se nuk do të ketë rritje pagash, që ishin premtuar e as nuk ka gatishmëri për implementimin e plotë të Marrëveshjes së përgjithshme Kolektive Kontratës Kolektive të sektorit të arsimit, të dyja këto të nënshkruara dhe të mbuluara me marrëveshjen se pjesa që kërkon implikime buxhetore do të vihet në jetë në janarin e vitit 2015, Këshilli Drejtues i SBASHK-ut, që është

organi më i lartë sindikal mes dy Kongreseve, në emër të demokracisë së brendshme ka shpërndarë nëpër gjithë shkollat e Arsimit Parauniversitar formularë për deklaram.

Nga këta formularë vërehet se mësimdhënësit e Kosovës kanë autorizuar Këshillin Drejtues, Kryesinë dhe kryetarin e SBASHK-ut që nëse deri më 9 janar nëse JU përfaqësuesit më të lartë të Kosovës nuk reflektoni në angazhimet për dialog dhe përmbushje të kontratës dhe hapjes së dialogut për ngritje pagash, atëherë SBASHK-u do të fillojë më 10 janar me veprime sindikale sipas Ligjeve gjegjëse dhe Statutit të kësaj Sindikate.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsimit e Kosovës

KEC



Të nderuar udhëheqës të lartë të shtetit të Kosovës kjo do të thotë se nëse mungon reflektimi Juaj në mesin e janarit do të shpallet greva e përgjithshme dhe do të ndërpritet mësimi në të gjitha shkollat fillore e të mesme të Kosovës.

Ju drejtohem me apelin që të veproni në përmbushje të Kontratës sonë Kolektive, që është nënshkruar më

11 prill 2014 në mes të MASHT dhe SBASHK dhe ta hapini mundësinë për dialogun për ngritje pagash. Nga Ju varët se cila do të jetë situata në shkollat e Kosovës.

JU përshëndesë duke shprehur gatishmërinë për takime me Ju dhe për bashkëbiseda në shërbim të zgjidhjes së këtyre kërkesave legjitime e reale.

Rrahman Jasharaj,
Kryetar i SBASHK-ut

Këshilli Drejtues mbështet angazhimet për implementimin e plotë të Kontratës Kolektive



Për të analizuar arritjet dhe sfidat gjatë muajit dhjetor është mbledhur Këshilli Drejtues i SBASHK-ut në mbledhjen vjetore të tij. Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, ka informuar përfaqësuesit nga të gjitha komunat e Kosovës se në SBASHK janë shënuar arritje të konsiderueshme falë unitetit dhe angazhimit të përbashkët në nivelin qendror dhe atë lokal.

Këshilli Drejtues është informuar se janë bërë gjithë përgatitjet për organizimin e suksesshëm të Konferencës Ndërkombëtare "Sindikata e Arsimit sot- arritjet dhe sfidat",. Në këtë takim me rëndësi do të

marrin pjesë përfaqësues të Sindikatave simotra nga vendet e Ballkanit dhe Evropës.

Anëtarët e Këshillit Drejtues janë informuar edhe për angazhimet e bëra për një kontratë unike individuale dhe për qëndrimin që Kontrata Kolektive të vihet në jetë e tëra në janarin e vitit 2015. Kryesia e SBASHK-ut ka marrë përgëzime për angazhimet e deritashme dhe ka marrë mbështetje që në takimet e të gjitha niveleve ta mbrojë kërkesën legjitime që Kontrata Kolektive të implementohet në tërësi në janar. Me qëllim që Kryesia dhe Këshilli Drejtues të vazhdojnë të jenë zë i anëtarësisë është marrë qëndrim në këtë takim që të vazhdohet bashkëbisedat me kryetarë shoqatash sindikale, por edhe me anëtarësinë nëpër shkolla me qëllim që veprimet të jenë të bazuara dhe të mbështetura nga të gjithë.

Këshilli Drejtues ka vlerësuar se gëzon uniteti në SBASHK dhe se kjo atmosferë e punës dhe angazhimit të përbashkët është përgjigje e fuqishme ndaj përpjekjeve mjerane të një grupi individësh për ta goditur unitetin e SBASHK-ut.



Këshilli Drejtues ka bërë edhe vlerësimin në shërbim të anëtarësisë duke lavdëruar arritjet në nënshkrimin e marrëveshjeve me biznese për zbritje çmimesh të shërbimeve dhe artikujve në shërbim të anëtarëve të SBASHK-ut. Ata kanë kujtuar se ishte caktuar si detyrë të nënshkruheshin 10 marrëveshje me institucione private shëndetësore e me biznese, por deri tani janë nënshkruar 50 sosh. Kjo arritje është fryt i angazhimit të përbashkët të SBASHK-ut në qendër dhe në nivelet komunale.

Në këtë takim është prezantuar nga menaxheri financiar i SBASHK-ut, z. Ymer Ymeri, Projektbuxheti i SBASHK-ut i vitit

2015. Pas debatit konstruktiv dhe përmbajtjesor Këshilli Drejtues ka aprovuar buxhetin për vitin e ardhshëm.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsimit e Kosovës

KEC



Kuvendi i Sindikatës së Arsimit Fillor me kryetar të ri

Më 6 Dhjetor 2014 u mbajt Kuvendi i Jashtëzakonshëm Zgjedhor i Sindikatës së Arsimit Fillor në nivel vendi, ku u zgjodh dhe kryetari i ri. Ky Kuvend zgjedhor është mbajtur në ambientet e Qendrës së studentëve dhe në të ka pasur debate përmbajtësore. Pas kësaj është kaluar në zgjedhjet për kryetarin e ri të SAF. Në mesin e tre kandidatëve të propozuar, me vota të fshehta të 51 pjesëmarrësve, ku vetëm një votë ishte e pavlefshme, në raundin e parë është zgjedhur Murat Abazi kryetar i SAF me 28 vota.

Në këtë Kuvend pjesëmarrës ishte edhe një pjesë e Kryesisë së SBASHK-ut dhe kryetari Rahman Jasharaj. Kryetari si dhe anëtarët tjerë të Kryesisë së SBASHK-ut i kanë shprehur përkrahje të plotë kryetarit të ri të SAF me premtimin se do të jenë me të në çdo angazhim në shërbim të arsimit në vend.



U mbajt mbledhja konsultative me kryetarët komunal të SAF dhe SAM të SBASHK-ut



Për ta analizuar situatën aktuale dhe për të marrë qëndrime lidhur me veprimet në vijim është mbajtur takimi konsultativ me kryetarët e Kuvendeve të SAF e SAM të komunave të Kosovës. Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj ka informuar të pranishmit me aktivitetet që janë zhvilluar këtyre ditëve në përpjekje të mbrojtjes së kërkesave legjitime të anëtarësisë. Kryetarët e Kuvendeve të Sindikatave të SAF e SAM nga komunat e Kosovës kanë informuar se kanë shpërndarë formularët nëpër të gjithë shkollat dhe mësimdhënësit janë duke u nënshkruar masovikisht në ata formularë duke shprehur

kështu unitetin e fuqishëm dhe duke i dhënë forcë e përkrahje kryesisë së SBASHK-ut për angazhime dhe për të nisur edhe me veprime sindikale nëse Qeveria nuk reflekton ashtu si duhet.

Pas diskutimeve konkrete, Këshilli Drejtues nxori këto përfundime: Janë shpërndarë formularët e deklarimit, Gëzon uniteti i shkëlqyer mes anëtarëve të SBASHK-ut dhe se pjesa e mbetur e formularëve do të dorëzohen në SBASHK deri më 5 janar.

Është vendosur që nëse Qeveria nuk reflekton ndaj kërkesave të SBASHK-ut deri më 9 janar, atëherë më 10 janar do të thirret Këshilli Drejtues dhe duke u bazuar në deklaratimet e anëtarësisë së gjerë do të nis me veprime sindikale duke përshkallëzuar ato deri edhe të grevë të përgjithshme. Këshilli Drejtues ka përkujtuar se në rast se vjen deri të këto veprime, atëherë përgjegjësinë do ta ketë Qeveria.

Ky takim ishte i hapur dhe është mbajtur në prani të medieve.



SBASHK-u në aktivitet të realizimit të kërkesave të anëtarësisë

Më 22 dhjetor 2014, një delegacion i SBASHK-ut, i kryesuar nga kryetari z.Rahman Jasharaj, vizituan ministrin e Arsimit, z.Arsim Bajrami, ku fillimisht SBASHK-u i uroj detyrën ministrit.

Ata biseduan rreth caktimit të agjendave të përbashkëta për takime me interes. Palët u dakorduan të vazhdojnë bashkëpunim konstruktiv dhe korrekt, dhe po ashtu u dakorduan që në javën e ardhshme të mbahet një takim i

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



SBASHK-u në takime me shefat e grupeve parlamentare

Nënkryetari i parë i SBASHK-ut, z.Lutfi Mani, së bashku me përfaqësuesit nga sindikata e policisë, shëndetësisë dhe administratës u takuan me grupin parlamentar të PDK-së. Ata u mirëpritën nga kryetari i grupit parlamentar të PDK-së, z.Adem Grabovci, si dhe Flora Brovina, Zenun Pajaziti dhe Agim Aliu. Në këtë takim temë kryesore ishte kërkesa e sindikatave të punëtorëve të Kosovës drejtuar institucioneve të Kosovës, gjegjësisht Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës. Përfaqësuesit e Sindikatave të Kosovës, kanë

kërkuar realizimin e kërkesave të tyre, që kanë të bëjnë me zbatimin e Kontratës Kolektive, Ligjit të Sigurimeve Shëndetësore, Ligjin e Punës dhe rritjen e pagave për 25 për qind për të gjithë shërbyesit civil dhe kategoritë e tjera.

Ndërkaq, përfaqësuesit e grupit parlamentar kanë shprehur zotimin e tyre institucional dhe gatishmërinë e deputetëve të PDK-së për t'u dhënë mbështetje të vazhdueshme të gjithë punonjësve në vend pa përjashtim.



Në vazhden e takimeve me shefat e grupeve parlamentare, SBASHK-u, i përfaqësuar nga nënkryetari z.Lutfi Mani, së bashku me sindikatat me të cilat kemi edhe memorandum bashkëpunimi u takuan me shefin e grupit parlamentar të LDK-së, z.Ismet Beqiri.

Ashtu si edhe në takimet me shefat tjerë të grupeve parlamentare, temë diskutimi ishte çështja e rritjes së pagave si dhe zbatimi në tërësi i Kontratës Kolektive

SBASHK-u merr pjesë në aktivitete të shumta



Më 19 dhjetor 2014, kryetari i SBASHK-ut z.Rrahman Jasharaj ishte pjesë e tryezës gjithë-përfshirëse të shoqatave me anëtarësi, në cilësinë e njërit prej panelistëve, organizuar nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D).

Qëllimi i tryezës ishte mobilizimi i anëtarëve, përkrahja e shoqatave, si dhe zhvillimi i mëtutjeshëm. Përmirësimi i ambientit politik dhe ligjor që mundëson lobim dhe avokim të suksesshëm ishin disa nga temat e tryezës. Kryetari z.Jasharaj, foli për angazhimet e SBASHK-ut për anëtarësinë si dhe për situatën e tanishme rreth implementimit të plotë të Kontratës

Kolektive, ku përmendi se nëse kjo e fundit nuk zbatohet, atëherë SBASHK-u me gjithë anëtarësinë e vet është gati të ndërmerri veprime sindikale, duke përdorë edhe mjetin sindikal – grevën e përgjithshme.

Në të njëjtën kohë, nënkryetari i parë i SBASHK-ut, z.Lutfi Mani ishte pjesë e takimit të grupit punues të Binjakëzimit për Implementimin dhe Zhvillimin e Mëtutjeshëm të Kornizës së Kurrikulës, me temën: Mbështetja e Implementimit të Planit Strategjik të arsimit në Kosovë 2011-2016, organizuar nga RTA, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, dhe financuar nga BE.



Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsimit në Kosovë

KEC



Seideneck i Konfederatës së Sindikatave Evropiane viziton SBASHK-un



Këshilltari i lartë i ETUC ishte në Kosovë për të parë nga afër angazhimet e sindikatave aktive dhe arritjet e sfidat e tyre. Ai është takuar me përfaqësues të SBASHK-ut dhe u ka shprehur atyre përgëzimet për angazhimet dhe arritjet. “Ju jeni të organizuar mirë dhe po shënoni rezultate pozitive në shërbim të anëtarësisë. Ju përgëzoj edhe për angazhimet në krijimin e atmosferës pozitive për bashkëpunim mes sindikatave aktive në Kosovë”, i ka thënë Seideneck kryetarit të SBASHK-ut Rahman Jasharajt dhe përfaqësuesve të tjerë të kësaj sindikate. Seideneck ka deklaruar se angazhim i tij, i të

deleguarit të ETUC-it, z. Maliq Ibrahimit dhe i z. Alush Berishës është që të koordinohet angazhimi i përbashkët i Federatave sindikale për të krijuar parakushtet për ndryshuar gjërat në jetën sindikale në Kosovë.

“ Ju jeni duke punuar mirë dhe keni arritje, por ju duhet një Konfederatë , pra sindikatat duhet të jenë në të njëjtën shtëpi sepse ashtu zëri i tyre është më i fuqishëm”, është shprehur Seideneck. Ai ka deklaruar se në BSPK duhen bërë reforma pozitive dhe se për këtë duhet dhënë kontribut pikërisht sindikatat aktive duke përmendur SBASHK-un, Sindikatën e shëndetësisë, të policisë dhe sindikal të tjera që po shënojnë rezultate. Seideneck ka përmendur në takim me SBASHK-un se ETUC po përgatit një projekt të madh të përkrahjes për sindikatat në Ballkan e Evropë dhe nga kjo përkrahje nuk do të përjashtohet as Kosova me kusht që sindikatat të jenë nën një kulm e në një Konfederatë të reformuar.

Kuvend i suksesshëm i SUSHK-ut

Më 18 dhjetor është mbajtur një Kuvend pune i Sindikatës së Universitetit (SUSHK), që vepron me sukses në kuadër të SBASHK-ut.

Në hapje të këtij Kuvendi, kryetari i SUSHK, z. Bardh Bardhi ka përshëndetur pjesëmarrësit dhe anëtarët e kryesisë së SBASHK-ut e pastaj ka dhënë një raport të detajuar për punën dhe angazhimet e shumta që janë bërë në SUSHK e në shërbim të anëtarësisë në Universitet. Z. Bardhi është shprehur se tani ndjehen edhe më të fuqishëm pasi mes tyre janë edhe përfaqësues të sindikatës nga Universiteti publik “Isa Boletini” nga Mitrovica. Kryetari Bardhi dhe anëtarët tjerë të Kuvendit dhe kryesisë së SUSHK-ut janë shprehur se hetohet një mobilizim dhe një unitet i shkëlqyer në SUSHK, por edhe në SBASHK kudo në qendër e në komunat e Kosovës. Ata kanë cekur se falë këtij aktiviteti dhe komunikimit të drejtë me të gjithë radhët e SBASHK-ut vetëm në tetor e nëntor janë shtuar për 1041 anëtarë dhe ky trend i shtimit të radhëve po vazhdon dhe për këtë si shembull konkret



kanë cekur ardhjen e dy fakulteteve nga Mitrovica. Të pranishmit kanë cekur se si rezultate të veçanta të SUSHK-ut janë edhe Marrëveshjet me menaxhmentin e UP-së për rritjen dhe harmonizimin e pagave, hartimin e Kontratës Kolektive, vazhdimi i formimit të shoqatave sindikale në disa fakultete, anëtarësimi në

SUSHK, pra në SBASHK, i disa fytyrave eminente dhe arritje të tjera të përbashkëta. Ky Kuvend ka lavdëruar edhe klimën e mirë të bashkëpunimit me Rektorin e ri, të cilit në takimin njohës i kanë dhënë përkrahje në angazhimet në shërbim të arsimit të lartë. Është thënë se edhe Rektori ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim dhe përkrahjen për aktivitetet dhe angazhimet e SUSHK-ut në shërbim të anëtarësisë.

Pjesëmarrësit në këtë takim kanë deklaruar se përpjekjet aty e këtu të ndonjë individi për ta dobësuar unitetin në SUSHK dhe SBASHK kanë dështuar dhe se sindikalistët janë unik dhe do të vazhdojnë me angazhimet në shërbim të anëtarësisë.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsimit e Kosovës

KEC



Një lutje e madhe nga SBASHK për deputetët e Parlamentit të Kosovës

28 dhjetor 2014 - Të nderuarit deputetë të Parlamentit të Kosovës në emër të Kryesisë dhe Këshillit Drejtues të SBASHK-ut i kam drejtuar letra krerëve të gjithë institucioneve të larta të Kosovës me qëllimin më të mirë e duke kërkuar që ata të reflektojnë në shërbim të arsimit e për të realizuar ato që janë premtuar e nënshkruar. Po Ju drejtohem edhe Juve të nderuar përfaqësues të zërit të popullit në Parlament.

Legjislacionet e kaluara ishin shembull i mirë i unitetit kur flitej, debatohej e vendosjes për çështjet në arsim. Ne jemi të sigurt se edhe Ju do ta mbani të gjallë këtë traditë. Ju lusim që nesër kur të debaton në leximin e dytë të Projektligjit të buxhetit jepni amendamente dhe propozime që do të mundësojnë vënien në jetë të Kontratës Kolektive të sektorit të arsimit. Krijoni me angazhimet dhe diskutimet Tuaja mundësi që të kthehen në veprë konkrete premtimet për rritje pagash, Nëse veproni kështu do ta keni urimin nga zemra të mijëra mësime dhënëseve. Nëse veproni e reflektoni do të krijoni atmosferë feste mes mësuesve të Kosovës që janë dëshmuar në kohët më të vështira dhe kanë mbajtur gjallë idealin për shtetësinë e Kosovës.

Të nderuar deputetë nëse reflektoni dhe angazhoheni për të realizuar këtë lutje tonën do të shprehni kështu respektin dhe do të dëshmoni se e mbani të gjallë kujtimin e mirë për mësuesin a mësuesen tuaj të parë. Ta tejkalojmë këtë situatë bashkë të nderuarit deputetë dhe ju krerët e institucioneve të shtetit tonë. Të punojmë bashkë në shërbim të arsimit të Kosovës.

Kryesia e SBASHK-ut,
Kryetari : Rahman Jasharaj

Konferenca përmbyllëse e SBASHK-ut e vitit 2014 me media



Kryesia e Sindikatës së Arsimit Shkencës dhe Kulturës, më 26 dhjetor 2014 në ambientet e kolegjit “Universum”, ka mbajtur një takim me gazetarë dhe përfaqësues të medie. Në takim janë prezantuar të arriturat e punës së SBASHK-ut për vitin 2014 si dhe sfidat që do ta përcjellin këtë organizatë edhe në vitin e ardhshëm. Me këtë rast, kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj duke folur për të arriturat e organizatës ka thënë që njëra nga të arriturat kryesore është nënshkrimi i Kontratës Kolektive Sektoriale me Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe

Teknologjisë.

“Kemi vazhduar negociimin për nënshkrimin e kontratës kolektive. Ju rikujtoj se SABSHK-u me MASHT-in kanë punuar 3 vjet bashkë, radhazi kanë negociuar në mënyrë që të vij prilli i vitit 2014 që të nënshkruhet kontrata që e kemi dhe e konsiderojmë dokument shumë me rëndësi për ne. Për të qenë sa më afër këtyre objektivave, SBASHK-u në mirëkuptim me MASHT-in të krijoj komisione të përbashkëta.” tha kryetari Jasharaj.

Ai po ashtu, ka përmendur një varg aktiviteteve tjera që SBASHK-u ka arritur t’i realizoj gjatë vitit që po e lëmë pas siç janë lobimi për rritjen e pagave për 25 për qind , formimi i komisionit të përbashkët MASHT-SBASHK për përpilimin e Projektligjit për mësime dhënësit e viteve 90-99, komisioni i përbashkët për përcjelljen e implementimit të Kontratës Kolektive, nënshkrimi i 70 marrëveshjeve me bizneset, institucionet shëndetësore e rekreative për zbritje çmimesh të shërbimeve për shërbim të anëtarësisë etj.

Jasharaj duke folur për sfidat kryesore të ardhshme të SBASHK-ut ka thënë që zbatimi i kontratës kolektive do të jetë prioritet i punës së SBASHK-ut.



“Sfidë që do ta përcjell SBASHK-un jo vetëm gjatë vitit 2015 por edhe gjatë tërë ekzistimit të saj me vite e dekada është se do të vazhdojmë me lobimin për realizimin e rritjes së pagave. Do me thënë, jemi të hapur për dialog me instancat më të larta të shtetit në mënyrë që të kemi ofertën e tyre, në mënyrë që të diskutojmë konkretisht për rritje pagash për ta rritur kështu edhe mirëqenien e arsimtarëve por edhe cilësinë në arsim. Ajo që nuk kemi pritur por ja që po ndodh është sfida për implementimin e tërësishëm të kontratës kolektive”, ka thënë Jasharaj.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Kryetari Jasharaj, po ashtu ka uruar të gjithë mësimdhënësit për përmbylljen e suksesshme të këtij viti. “E kam nderin që në emër të kryesisë dhe të gjithë anëtarëve të kryesisë t’i përgëzoj mësimdhënësit e arsimit parauniversitar por edhe mësimdhënësit dhe të punësuarit tjerë në universitet që janë anëtarë të SUSHK-ut dhe të gjithë këta anëtarë të SBASHK-ut të ju uroj një vit sa më të mirë dhe t’i përgëzoj për përmbylljen e gjysmë vjetorit të parë me sukses dhe të përmbylljes së arritjeve shumë të mëdha në universitet”, ka uruar kryetari Jasharaj.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC

